



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 25.04.2013

Nr. 0204 - 499

**PËR:** Isni Kilaj, Kryetar i Komunës së Malishevës  
Ragip Begaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës

**LËNDA:** KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË  
MALISHEVËS, Nr. 02/72, Pranuar me datë, 12.04.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 02/72, të miratuar me datë 03.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 02/72, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL,  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 25.04.2013  
br. 0204 - 499

**Za:** Gradonačelnik opštine Mališevo  
Enver Mavriqi, Predsedavajući Skupštine opštine Mališevo

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluke opštine Mališevo, br. 02, Primijeno dana ,  
12.04.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 02, odobreno dana 03.04.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka br. 02/72 o osnivanju opštinske komisije akcionara.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.

0264-4999

0264-4999  
Kuvendi i Komunës  
Nr. 02/\_\_\_\_  
Datë: 03.04.2013  
02/70



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës  
Nr. 02/\_\_\_\_  
Datë: 03.04.2013

Mbështetur në nenet 11, 12, dhe 40.2( shkronja e ) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Ligji nr.03/L-040, në mbështetje të ligjit për Shoqëritë tregtare Ligji nr.02/L-123, ligjit për ndërmarrjet publike Ligji nr. 03/L-087, neni 5 par.5.2, neni 7 par. 7.3 dhe neni 8 par. 8.2, mbështetur në nenin 6 të ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa nr.02/63 datë 19.03.2013, si dhe në pajtim me Statutin të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë 12.11.2008.

*Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë, 28.03.2013, mori këtë:*

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE**

**Neni 1**

Miratohet, kërkesa e kryetarit të Komunës nr.01/351 e datës 18.03.2013, për formimin e komisionit komunal të Aksionarëve

**Neni 2**

Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi komisioni do të jetë në përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe mandati i tyre do të jetë i përcaktuar me këtë mandat të kuvendit të Komunës.

**Neni 3**

Pagesa për anëtarët e këtij komisioni për çdo mbledhje është përcaktuar të jetë 50 (pesëdhjete euro)

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesen Kryetari i Komunës .

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Malishevës.

Vendimi iu dërgohet:  
Arkivit  
MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit  
Ragip Begaj

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS KOMUNALITETI I MALISHEVËS Kuvendi i Komunës së Malishevës			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration			
Data		12.04.2013	
Data			
Prokuror	Nr. i llogarit	Shënim	Vlera